



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 03.10.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 28.09.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik " IZO - H" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Renovimi dhe adaptimi i objekteve të çerdhes Ganimete Tërbeshi", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-7721-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-117 -521, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik " IZO - H" SH.P.K. e dt.28.09.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Renovimi dhe adaptimi i objekteve të çerdhes Ganimete Tërbeshi", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-7721-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-117 -521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 26.09.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 26.09.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të anulohet aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

## Arsyetim

Me dt.28.09.2023, Operatori Ekonomik " IZO - H" SH.P.K., ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "Renovimi dhe adaptimi i objekteve të çerdhes Ganimete Tërbeshi", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-7721-5-2-1, Nr. i brendshëm- 632-23-117 -521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 03.04.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj nuk qëndron, sepse ju në platform keni ofertuar si Operatorn ekonomik i vetëm kurse brenda ofertës i keni futur dokumentet si konzorcium, çka është në kundërshtim me nenin32, paragrafi 32.9 i Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022:

**32.9 "Në rast se tenderi dorëzohet në emër të Grupit të Operatorëve Ekonomik, Formulari i Dorëzimit të Tenderit (nëse është e aplikueshme) duhet të nënshkruhet nga personi i autorizuar, duke përdorur nënshkrimin e avancuar digjital, në emër të grupit të OE."**

Si Operator Ekonomik ju nuk keni qarkullim financiar me një vlerë të përgjithshme prej së paku 290.000,00€, gjatë tre viteve të fundit, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% të vlerës së qarkullimit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

### **Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

**Faton Gutaj**  
  
**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;  
Arkivit të Komunës